

EXTERNAL AUDIT AND QUALITY OF FINANCIAL REPORTING

Agim Kastrati

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, akastrati7@hotmail.com

Abstract: This paper was created to provide a scientific analysis on the impact of auditing on the achievement of company objectives in Kosovo. In the past, auditing have been considered as a simple administrative procedure comprised mainly of checking accuracy of transactions and financial reporting. Companies are moving towards a higher level of transparency and demonstrate accountability and stewardship in the use of resources entrusted to them. Auditing helps top management manage corporate affairs, providing guidance on various issues ranging from financial accuracy to regulatory compliance. Auditing also help department heads identify tools and methodologies to improve operational activities, putting companies on a more sustainable path.

The findings from the literature are based on studies conducted in relatively large enterprises in economically developed countries, therefore reliance on them in terms of Kosovar business should be done carefully and only after verifying that these findings can be generalized to the conditions of Kosovar business.

The information obtained from businesses enabled us to identify essential topics related to business perceptions of the benefits of auditing financial statements in Kosovo. The analysis of the obtained data proved that the audited companies are the ones who expect from the audit a significant advantage in terms of quality of financial reporting, improvement of internal control, improvement of errors, detection of abuses, attracting investors and favorable financing.

Companies whose audited financial statements are with unqualified audit opinion tend to have greater value, because unqualified audit opinion is the most positive of audit opinion that increases market response and confidence so that company's value is also positive.

Keywords: External auditing, financial statements

AUDITIMI I JASHTËM DHE CILËSIA E RAPORTIMIT FINANCIAR

Agim Kastrati

Kolegji Biznesi Prishtinë, Kosovo, akastrati7@hotmail.com

Përmbledhje: Ky punim ka për qëllim analizën e ndikimit të auditimit në arritjen e objektivave të kompanive në Kosovë. Auditimi në të kaluarën është konsideruar si një procedurë e thjeshtë administrative e përbërë kryesisht nga kontrolli i saktësisë së transaksioneve dhe raportimi financiar. Kompanitë janë duke lëvizur drejt një niveli më të lartë të transparencës dhe llogaridhënies lidhur me administrimin e burimeve që i janë besuar menaxhmentit. Auditimi ndihmon menaxhmentin e lartë për të menaxhuar punët e korporatave, duke siguruar udhëzime për çështje të ndryshme duke filluar nga saktësia e raportimit financiar deri te pajtueshmëria rregullative. Rekomandimet e dhëna nga audituesit ndihmojnë drejtuesit e departamenteve të identifikojnë mjetet dhe metodologjitë për të përmirësuar aktivitetet operative, duke i vendosur kompanitë në një rrugë më të qëndrueshme.

Gjetjet nga literatura bazohen në studimet e bëra në ndërmarrje relativisht të mëdha në vende ekonomikisht të zhvilluara, prandaj mbështetja në to në kushtet e afarizmit kosovar duhet të bëhet me kujdes dhe vetëm pasi që të verifikohen se këto gjetje mund të përgjithësohen edhe në kushtet kosovare të afarizmit.

Informatat e përftuara nga terreni na mundësuan të identifikojmë temat thelbësore që lidhen me perceptimet e bizneseve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare në Kosovë. Analiza e të dhënave të përftuara dëshmoi se ndërmarrjet e audituara janë ato që presin nga auditimi një përparësi të konsiderueshme në pikëpamje të cilësisë së raportimit financiar, përmirësimin e kontrollit të brendshëm, përmirësimin e gabimeve, zbulimin të shpërdorimeve, përfitimin të investimeve, financimit me kushte të volitshme, etj.

Kompanitë, pasqyrat financiare të audituara të të cilave janë me mendim të pakualifikuar të auditimit kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe, sepse opinioni i pakualifikuar i auditimit është niveli më pozitiv i opinionit të auditimit që rrit reagimin dhe besimin e tregut në mënyrë që vlera e kompanisë të jetë gjithashtu pozitive.

Fjalët kyçe: Auditimi i jashtëm, pasqyrat financiare

1. HYRJE

Pasqyrat financiare të përgatitura nga menaxhmenti, për shkak të interesave të ndryshme në mes të palëve të interesuara, mund të mos paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen e ndërmarrjes dhe rezultatet e veprimtarisë së saj. Për këtë arsye pronarët angazhojnë një auditues - palë e tretë e cila në mënyrë profesionale dhe të pavarur do të

verifikojë saktësinë e pasqyrave financiare. Raporti i auditimit është dokument publik të cilën ndërmarrja mund ta përdorë si dokument të besueshëm dhe të paanshëm se pasqyrat financiare të sajë janë të sakta dhe pa gabime.

Ky studim ka për qëllim të identifikojë perceptimet e bizneseve për përfitimet e tyre nga auditimi i pasqyrave financiare. Ky qëllim mund të arrihet nëse bëhet identifikimi i faktorëve që ndikojnë te bizneset që t'i auditojnë pasqyrat e tyre financiare. Fillimisht iu kemi qasur shfletimit të literaturës e cila ka të bëjë me përfitimet e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare dhe gjetjet nga literatura na kanë shërbyer si bazë në punën e mëtejme. Më pas i kemi qasur mbledhjes së të dhënave nga bizneset, përmes intervistave të zhvilluara me përfaqësuesit e tyre, lidhur me ndikimin e auditimit të pasqyrave financiare në cilësinë e raportimit financiar.

Gjetjet nga literatura dhe ato të përfituara nga intervistat si dhe rastet e gjetjeve nga puna praktike në auditim na kanë shërbyer për hartimin e pyetësorit kërkimor. Të gjitha këto na kanë ndihmuar në identifikimin e faktorëve ndikues në përcaktimin e bizneseve për auditimin e pasqyrave financiare, gjegjësisht përfitimet që kanë ndërmarrjet nga auditimi i pasqyrave financiare duke dashur të bëjmë promovimin e praktikës së auditimit të pasqyrave financiare dhe rritjen e transparencës së afarizmit të bizneseve.

Rezultatet e këtij studimi do të kenë ndikime të shumfishta pozitive, veçmas në ngritjen e transparencës në lidhje me afarizmin e bizneseve dhe gjendjen financiare të tyre, joshjen e investitorëve të jashtëm si dhe krijimin e evidencës empirike lidhur me ndikimin e auditimit të jashtëm në cilësinë e raportimit financiar.

Literatura e cila studion përfitimet e bizneseve nga auditimi, mbështet dobishmërinë e bizneseve nga auditimi i pasqyrave financiare. Me këtë çështje janë marr hulumtues të shumtë të cilët kanë ardhur në përfundime se nga auditimi i pasqyrave financiare përmirësohet kontrolli i brendshëm i ndërmarrjes së audituar, zvogëlohet rreziku i investitorëve dhe kredidhënësve, zbulohen gabime dhe mashtrime në ndërmarrjet e audituara, duke i sjell kështu përfitime të shumta atyre ndërmarrjeve. Shelton dhe Whittington (2008), erdhi në përfundim se raporti i audituesit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm jep informacion të rëndësishëm për investitorët. Ndërkaq, Fallatah (2008), ka gjetur se auditimet cilësore ndikojnë në besueshmërinë e raportimit financiar i cili zvogëlon rrezikun e investimit. Monitorimi i jashtëm i entitetit nga audituesit njëkohësisht nxit menaxhmentin të angazhohet në monitorimin e brendshëm duke përmirësuar kështu sistemin e kontrollit të brendshëm të tij (Ghosh, 2007). Clement (2012) e cilësoi auditimin si një mjet për të vlerësuar efektivitetin e kontrollit të brendshëm të një kompanie, duke ruajtur një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Informatat financiare cilësore janë thelbësore për arritjen e objektivave të biznesit të një kompanie, parandalimin e mashtrimit dhe keqpërdorimit të pasurive të saj dhe minimizimin e kostos së kapitalit. Putu (2014), ka gjetur se kompanitë, pasqyrat financiare të audituara të të cilave janë me mendim të pakualifikuar të auditimit kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe. Satka (2017) ka ardhur në përfundim se auditimi është i rëndësishëm dhe duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe nga udhëheqësit, për këtë arsye, rekomandohet që në të ardhmen të hartohen udhëzime specifike nga auditimi të cilat duhet të jenë më të shpeshta, në mënyrë që të arrihet efektiviteti i menaxhimit të ndërmarrjes. Ismajli et al. (2019) kanë ardhur në përfundim se auditimi i jashtëm në sektorin publik duhet të shihet si një profesion që shton vlerë dhe kontribuon në rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Sattar et al. (2020), kanë gjetur se aksionarët dhe pronarët duhet të marrin pjesë në një treg konkurrues për auditim cilësor i cili mund të ndikojë që kompanitë të kenë fitime më të larta.

2. METODOLOGJIA

Në këtë punim kemi përdorur kryesisht metodat e kërkimit cilësor, përmes të cilave kemi synuar të kuptojmë më thellë përgjigjet e individëve lidhur me problematikën e paraqitur. Në këtë drejtim kemi aplikuar një tërësi procedurash që karakterizohen me mbledhjen e të dhënave nga vëzhgimet e drejtpërdrejta të sjelljeve njerëzore, e në rastin tonë të ekspertëve të fushës së raportimit financiar dhe të menaxherëve të kompanive. Përdorimi i metodës cilësore ka mundësuar marrjen e informacioneve mbi rastet e marra në studim dhe konkluzionet e përgjithshme na kanë shërbyer si pohime informuese.

Metodologjia e ndjekur në këtë punim bazohet në dy burime të dhënash: në burimet parësore dhe ato dytësore.

Për nxjerrjen e konkluzioneve, një rëndësi e veçantë i është kushtuar burimeve parësore, të cilat përfaqësohen nga të dhënat e mbledhura me anë të pyetësorëve drejtuar profesionistëve të punësuar në lëmin e raportimit financiar dhe menaxherëve të kompanive. Arsyeja kryesore e përzgjedhjes së këtij grupi të interesit është që nga vet palët e interesuara të marrim vlerësimet lidhur me efektivitetin e auditimit dhe cilësinë e raportimit financiar, me qëllim që të vijmë deri te gjetjet e nevojshme të cilat shërbejnë si bazë për dhënien e rekomandimeve të duhura. Mbledhjen e të dhënave nga terreni për këtë punim e kemi bërë gjatë punës së auditimit të pasqyrave financiare në prill të vitit 2019 me rastin e kontakteve me klientët tanë. Me rastin e intervistimit kemi orientuar në përdorimin e intervistave gjysmë të strukturuar. Përcaktimi për këtë lloj intervistash është bërë për shkak se intervistat gjysmë të strukturuar lejojnë mundësinë e të bërit të pyetjeve, për ndonjë çështje, të cilat lindin qoftë edhe gjatë intervistimit, meqenëse disa nga pyetjet kanë qenë me fund të hapur, me qëllim që i intervistuari të ketë mundësi të përgjigjes së hapur, duke i dhënë më shumë mundësi të njëjtit që të shpreh qëndrimet e tij dhe të jep arsyetimet gjegjëse.

Me anë të burimeve dytësore është bërë një studim gjithëpërfshirës në drejtim të hulumtimit dhe analizës së punimeve të shumta lidhur me efektivitetin e auditimit të bëra nga studiues të ndryshëm. Në fokus në këtë aspekt do të jetë analiza e përparësive dhe të metave të auditimit për bizneset.

Burimet e mbledhura dytësore kanë shërbyer për të ndërtuar kuadrin teorik. Për gjetjen e të dhënave dytësore që janë përdorur si pika referimi për këtë studim, kryesisht është shfrytëzuar interneti. Përmes faqeve të ndryshme të internetit kemi vënë në dispozicion shumë artikuj, revista, materiale zyrtare të institucioneve rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përpunimi i të dhënave do të realizohet në një proces i cili kalon në disa faza. Në fazën e parë të dhënat i nënshtrohen analizës eksploruese për t'u ndjekur nga analiza konfirmuese. Modeli vazhdon me kryerjen e një sërë testesh vlerësimi, për të përfunduar me analizën dhe testimin e çështjeve kryesore të ngritura në punim.

3. REZULTATET

Përdorimi i metodave cilësore të studimit përmes përgjigjeve të pranuar nga palët të cilat kanë qenë të kyçura në problematikën e shtruar në këtë punim na kanë mundësuar të vijmë deri te rezultatet e duhura. Shumica e të intervistuarve kanë deklaruar se auditimin e kanë vlerësuar bazuar në përfitimet që sjell. Shtimi i besueshmërisë së pasqyrave financiare dhe rritja e cilësisë së raportimit financiar si rezultat i auditimit është gjetja më e rëndësishme nga ndërmarrjet me pasqyra financiare të audituara duke i vënë ato në përparësi të shumta. Në përgjigjet e palëve të intervistuara është theksuar se investitorët dhe bizneset në tërësi kanë nevojë për raportime financiare cilësore dhe të besueshme dhe në këtë kontekst auditori luan një rol kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe të investitorëve. Në këtë kontekst të intervistuarit kanë theksuar një mori përparësish që kanë ndërmarrjet me pasqyra financiare të audituara në joshjen e investimeve të jashtme. Në aspektin e marrjes së kredive biznesore gjithashtu janë theksuar disa përparësi nga ana e përfaqësuesve të bizneseve. Kredihënësit kanë bërë zbritje të normave të interesit si rezultat i auditimit dhe bizneset kanë arritur që të kursejnë shpenzimet e tyre. Përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm si rezultat i rekomandimeve nga audituesi është gjetje tjetër e rëndësishme e cila ka dal nga të dhënat e fituara nga studimi ynë. Gjatë procesit të auditimit testohet edhe funksionimi i kontrollit të brendshëm të biznesit dhe me këtë rast jepen rekomandimet lidhur me dobësitë e vërejtura dhe përmirësimet që duhet të bëhen. Në këtë mënyrë të intervistuarit kanë theksuar se rekomandimet e dhëna nga audituesi lidhur me kontrollin e brendshëm kanë qenë të mirëseardhura për funksionimin më efikas të proceseve të biznesit. Përmirësimi i gabimit si rezultat i auditimit të pasqyrave financiare nga ana e audituesit është gjetje e radhës e cila ka ndikim në zvogëlimin e shpenzimeve dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së biznesit. Zbulimi i shpërdorimeve në ndërmarrje, me rastin e auditimit të pasqyrave financiare, është gjetje tjetër që sjell efekte të dobishme për ndërmarrjen e audituar dhe palët e interesuara për afarizmin e saj. Të intervistuarit kanë theksuar se rekomandimet e bëra nga audituesi lidhur me parandalimin e gabimeve dhe mashtrimeve me anë të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiive kanë qenë të dobishme për ecurinë e mëtejme të punës së biznesit të tyre.

Përmirësimi i politikave kontabël të ndërmarrjes si rezultat i auditimit dhe rekomandimet lidhur me to është një gjetje gjithashtu me rëndësi të veçantë për afarizmin e suksesshëm të ndërmarrjes së audituar. Të intervistuarit kanë theksuar se përdorimi i gabuar i politikave kontabël iu ka kushtuar me shpenzime shtesë në aspektin e politikave fiskale dhe udhëzimet nga auditimi kanë mundësuar që të shmangin shpenzimet shtesë të biznesit si rezultat i politikave kontabël joadekuate.

Një gjetje e rëndësishme e këtij punimi është se auditimi ka ndikuar në rritjen e sigurisë afariste të ndërmarrjes dhe rritjen e vlerës së saj në treg. Në këtë aspekt ndikon edhe lloji i opinionit i cili jepet nga ana e audituesit. Kompanitë, pasqyrat financiare të audituara të të cilave janë me mendim të pakualifikuar të auditimit kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe në treg. Kjo sepse opinionin e pakualifikuar të auditimit është niveli më pozitiv dhe më i fortë i opinionit të auditimit që rrit reagimin dhe besimin e tregut në mënyrë që vlera e kompanisë të jetë gjithashtu pozitive. Në këtë drejtim të intervistuarit kanë theksuar se kompanitë e tyre kanë patur mundësi që të kenë përparësi në fitimin e kontratave të reja dhe në zgjerimin e veprimtarive të tyre.

4. DISKUTIMI

Rezultatet nga ky punim tregojnë se klientët e vlerësojnë auditimin bazuar në ndikimin që ka patur auditimi i pasqyrave financiare në cilësinë e raportimit financiar dhe në përmirësimin e veprimtarisë së biznesit. Përmirësimi i politikave kontabël dhe kontrollit të brendshëm si rezultat i auditimit vlerësohet të ketë ndikim të madh në zbatimin e rregullave dhe ligjeve që janë të zbatueshme në sferën e raportimit financiar, duke ndikuar që bizneset të kursehen nga ndëshkimet e mundshme nga autoritetet rregullative. Rekomandimet e dhëna nga ana e audituesit kanë patur ndikim të konsiderueshëm në ecurinë e biznesit dhe në parandalimin e parregullsiive të ndryshme. Zbatimi i udhëzimeve që rrjedhin nga auditimi i ka mundësuar bizneseve të kenë mundësi që të kursejnë shpenzimet e ndryshme dhe të arrijnë një rezultat më të mirë financiar. Bizneset kanë arritur të rrisin afarizmin e tyre duke patur

një rritje të qarkullimit pasi që kanë fituar më shumë kontrata të punës bazuar në shtimin e besueshmërisë dhe cilësisë së raportimit financiar. Roli i auditimit të pasqyrave financiare në rritjen e vlerës së biznesit ka qenë i lidhur me llojin e opinionit të dhënë nga audituesi. Në rastet kur për pasqyrat financiare të audituara është dhënë opinion i pakualifikuar, kompanitë kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe në treg. Kjo gjë arsyetohet me faktin se opinionit i pakualifikuar i auditimit është niveli më pozitiv dhe më i fortë i opinionit të auditimit që rrit reagimin dhe besimin e tregut ashtu që vlera e kompanisë të jetë gjithashtu në rritje. Në llojin e opinionit të auditimit ka ndikuar pozitivisht zbatimi i rekomandimeve të dhëna në vitet e mëparshme. Në vitet e mëparshme kompania mund të ketë pasur opinion jo të favorshëm, por nëse ka zbatuar rekomandimet e dhëna, në vitin vijues ka marrë opinion të pakualifikuar, duke patur ndikime pozitive në afarizmin e saj. Investuesit dhe kreditorët e ndryshëm e çmojnë lart besueshmërinë dhe cilësinë e raportimit financiar që sigurohet nga auditimi. Rritja e transparencës së afarizmit dhe të dhënat financiare të sakta kanë ndikim të madh në vendimmarrjet e tyre lidhur me angazhimin e kapitalit. Rezultatet që dalin nga ky punim janë në përputhje me gjetjet nga literatura, ashtu që shumë studiues kanë theksuar të arriturat e bizneseve fal auditimit. Në këtë drejtim Clement (2012) e cilësoi auditimin si një mjet për të vlerësuar efektivitetin e kontrollit të brendshëm të një kompanie, duke ruajtur një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Informatat financiare cilësore janë thelbësore për arritjen e objektivave të biznesit të një kompanie, parandalimin e mashtrimit dhe keqpërdorimit të pasurive të saj dhe minimizimin e kostos së kapitalit. Putu (2014), ka gjetur se kompanitë, pasqyrat financiare të audituara të të cilave janë me mendim të pakualifikuar të auditimit kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe. Satka (2017) ka ardhur në përfundim se auditimi është i rëndësishëm dhe duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe nga udhëheqësit, për këtë arsye, rekomandohet që në të ardhmen të hartohen udhëzime specifike nga auditimi të cilat duhet të jenë më të shpeshta, në mënyrë që të arrihet efektiviteti i menaxhimit të ndërmarrjes. Ismajli et al. (2019) kanë ardhur në përfundim se auditimi i jashtëm në sektorin publik duhet të shihet si një profesion që i shton vlerë dhe kontribuon në rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Sattar et al. (2020), kanë gjetur se aksionarët dhe pronarët duhet të marrin pjesë në një treg konkurrues për auditim cilësor i cili mund të ndikojë që kompanitë të kenë fitime më të larta. Kastrati (2019) ka ardhur në përfundim se raportimi financiar cilësor eliminon parregullsitë dhe zvogëlon informalitetin. Pasqyrat financiare të besueshme ndikojnë në ngritjen e sigurisë për kreditorët. Raportimi financiar i besueshëm ndikon në thithjen e investimeve nga jashtë. Në këtë mënyrë raportimi financiar cilësor, transparent dhe i besueshëm, ka ndikim të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi pasi që informacionet financiare që ofrohen nga pasqyrat financiare të subjekteve ekonomike kanë ndikim të madh në vendimmarrjet, si të investitorëve të ndryshëm ashtu edhe të kreditorëve dhe palëve tjera të interesuara.

5. PËRFUNDIM

Auditimi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në shtimin cilësisë dhe besueshmërisë së informacioneve nga pasqyrat financiare, duke ndihmuar vendimmarrësit që të vendosin për veprimet e tyre ekonomike të ardhshme duke u bazuar pikërisht në raportimet e besueshme financiare të vërtetuara përmes opinionit të audituesit. Efektet e auditimit janë të konsiderueshme në drejtim të përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të ndërmarrjes, i cili bëhet përmes zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga audituesi. Auditimi ndikon në mbarëvajtjen e afarizmit të ndërmarrjeve dhe arritjen e objektivave të menaxhmentit lidhur me funksionimin me sukses të ndërmarrjes duke ulur shpenzimet e panevojshme dhe duke rritur fitimin e saj. Joshja e investimeve të jashtme nga partnerë të ndryshëm është rezultat i besueshmërisë së raportimeve financiare që dalin nga pasqyrat financiare të audituara. Pasqyrat financiare të audituara ndihmojnë biznesit në gjetjen e burimeve të financimit në drejtim të marrjes së kredive me kushte të volitshme si në pikëpamje të shkallës së interesit ashtu edhe të afatit të kthimit të kredisë, duke ndikuar kështu në uljen e shpenzimeve të interesit dhe mundësimin e një afarizmi më të suksesshëm. Përmirësimi i politikave kontabël që arrihet përmes zbatimit të rekomandimeve që rrjedhin nga auditimi i ndihmon biznesit në zbatimin e normave rregullative në mënyrë që biznesi të kurset nga pasojat e mundshme në këtë drejtim.

Lloji i opinionit të auditimit ka një rëndësi të veçantë për një pasqyrë më të mirë të pozitës financiare të biznesit. Kompanitë, pasqyrat financiare të audituara të të cilave janë me mendim të pakualifikuar të auditimit kanë tendencë të kenë vlerë më të madhe. Kjo sepse opinionit i pakualifikuar i auditimit është niveli më pozitiv dhe më i fortë i opinionit të auditimit që rrit reagimin dhe besimin e tregut në mënyrë që vlera e kompanisë të jetë gjithashtu pozitive. Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i viteve të mëparshme ndikon që në vitin vijues të merret një opinion i pakualifikuar dhe të ketë ndikime pozitive në afarizmin e kompanisë. Në anën tjetër opinionit i auditimit është i rëndësishëm për kompanitë që synojnë të jenë pjesëmarrëse në bursa, pasi që vetëm opinionit i pakualifikuar është i pranueshëm për shumicën e bursave ndërkombëtare. Meqenëse bizneset kosovare synojnë të jenë pjesëmarrëse në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, atëherë edhe gjetjet nga literatura të studiuesve të ndryshëm janë relevante për kompanitë kosovare.

LITERATURA

- Al Ani, M.K., & Mohammed, Z.O. (2015). Auditor quality and firm performance: Omani experience. *Eur. J. Econ. Financ. Adm. Sci.*, 74, 13–23.
- Bradley, D. (2006). Auditing and its role in corporate governance, FSI Seminar on Corporate Governance for Banks.
- Chang, H., Cheng, A.C.S., & Reichelt, K.J. (2010). “Market Reaction to Auditor Switching from Big 4 to Thrid-Tier Small Accounting Firms”. *Auditing: A Journal of Practice and Theory*. Vol: 29. pp. 83-114.
- Chen, C.Y., Lin, C.J., & Lin, Y.C. (2008). “Audit Partner Tenure, Audit Firm Tenure and Discretionary Accruals: Does Long Auditor Tenure Impair Earnings Quality?”. *Contemporary Accounting Research*. Vol: 25. pp. 415-445. <http://dx.doi.org/10.1506/car.25.2.5>
- Elerroita, A. M. (2002). Disclosure and Transparency Accounting and Auditing, The Third Meeting of the Latin American Corporate Governance Roundtable, OECD & World Bank Group.
- Fallatah, Y. (2008). The role of asset reliability and auditor quality in equity valuation, Global Conference on Business & Economics.
- Fatma, Z. (2006). The Place of External Audit in the Management of Accounting Results. The Case of Tunisian Companies". *Accounting - Audit - Audit and Institution (s)*.
- Ghosh, S. (2007) External Auditing, Managerial Monitoring and Firm Valuation: An Empirical Analysis for India, *International Journal of Auditing*
- Guillamon, A. G. (2003). The usefulness of the audit report in investment and financing decisions, *Managerial Auditing Journal*
- Haddrill, S. (2010). Should statutory audit be dropped and assurance needs left to the market? ICAS Aileen Beattie memorial event.
- Hay, D., Knechel, W. R., & Willekens, M. (2014). *The Routledge companion to auditing*. Abingdon, Oxon: Routledge.
- Hylas, E. R. & Ashton H. R. (1982), Audit Detection of Financial statement Errors, *The Accounting Review*, Vol. L VII, No.4 .
- Ismajli, H., Perjuci E., & Prenaj, V. (2019). *Ekonomika* ISSN 1392-1258 eISSN 2424-6166, 2019, vol. 98(1), pp. 124–134 DOI: <https://doi.org/10.15388/Ekon.2019.1.8>
- Jayeola, O., Taofeek, O.A., & Toluwalase, A. O. (2017). Audit Quality and Earnings Management Among Nigerian Listed Deposit Money Banks, *Pyrex Journal of Taxation and Accounting Management*, Vol 1 (1) pp. 1-8.
- Kastrati, A. (2019). “Ndikimi i raportimit financiar në zhvillimin ekonomik” - *Knowledge-International Journal*. Vol.36.1, f. 31-35
- Matoke, V., & Omwenga, J. (2016). Audit quality and financial performance of companies listed in nairobi securities exchange. *Int. J. Sci. Res. Publ.* 6, 372–381.
- Putu Agus, A. (2014). The Role of External Audit in Improving Firm’s Value: Case of Indonesia
- Satka, E. (2017). *Journal of US-China Public Administration*, June 2017, Vol. 14, No. 6, 330-338 doi: 10.17265/1548-6591/2017.06.004 Internal and External Audit in the Function of the Management of the Trade Companies.
- Sattar, U., Javeed, S., & Latief, R. (2020), How Audit Quality Affects the Firm Performance with the Moderating Role of the Product Market Competition MDPI.
- Shelton, W. S., & Whittington O. R. (2008). The influence of the auditor’s report on investors’ evaluation after the Sarbanes-Oxley Act, *Managerial Auditing Journal*.
- Tagne, F., Vepgnou, N., & Kamdem, D. (2017). Incentive Fees at the Heart of a Reflection on Audit Quality in French-speaking Sub-Saharan Africa" *Journal of Academic Finance*
- Tricker, R. (2016). *ISO 9001:2015 audit procedures (4th ed.)*. Oxford, United Kingdom: Oxford University Press.
- Samuel, A. & Schwartz, J. (2019). Product market competition’s effect on earnings management when audit quality is endogenous: Theory and evidence. *Rev. Law Econ*, 15.